

Shoqata e kontabilistëve të certifikuar dhe auditorëve të  
Kosovës

Society of Certified Accountants and Auditors of Kosovo

**Raportimi Financiar**

**P5**

**Zgjidhjet**

FLETË PROVIMI  
Exam Paper

Data 11.06.2022

1. Grupi Commando sh.a përbëhet nga kompanitë që prodhojnë aeroplanë ushtarak. Pasyrat individuale të pozitës financiare të kompanisë prind Commando sh.a dhe kompanitë në të cilat ka investuar, Lancer sh.a dhe Spirit sh.a me 31 dhjetor 2021, janë dhënë më poshtë :

|                                       | Commando sh.a  | Lancer sh.a   | Spirit sh.a   |
|---------------------------------------|----------------|---------------|---------------|
|                                       | €'000          | €'000         | €'000         |
| <i>Pasuritë jo-qarkulluese:</i>       |                |               |               |
| Prona, Fabrika dhe paisjet            | 50,500         | 40,000        | 20,000        |
| Investimet                            | <u>50,000</u>  | <u>20,000</u> | <u>-</u>      |
|                                       | 100,500        | 60,000        | 20,000        |
| <i>Pasuritë qarkulluese:</i>          |                |               |               |
| Stoqet                                | 10,000         | 15,000        | 9,000         |
| Të arkëtueshmet tregtare dhe të tjera | 30,000         | 10,000        | 8,000         |
| Paraja dhe ekuivalentët e parasë      | <u>1,000</u>   | <u>2,000</u>  | <u>3,000</u>  |
|                                       | <u>41,000</u>  | <u>27,000</u> | <u>20,000</u> |
| <b>Total pasuritë</b>                 | <b>141,500</b> | <b>87,000</b> | <b>40,000</b> |
| <i>Ekuiteti:</i>                      |                |               |               |
| Aksionet e zakonshme prej €1 secila   | 50,000         | 50,000        | 10,000        |
| Fitimet e mbajtura                    | <u>50,000</u>  | <u>25,000</u> | <u>20,000</u> |
|                                       | 100,000        | 75,000        | 30,000        |
| <i>Detyrimet afatgjata:</i>           |                |               |               |
| Kredia afatgjatë                      | 20,000         | 2,000         | -             |
| <i>Detyrimet afstshkurta:</i>         |                |               |               |
| Të pagueshmet tregtare dhe të tjera   | <u>21,500</u>  | <u>10,000</u> | <u>10,000</u> |
| <b>Total Ekuiteti dhe detyrimet</b>   | <b>141,500</b> | <b>87,000</b> | <b>40,000</b> |

#### **Informatat tjera:**

- (i) Commando sh.a më 1 janar 2021 bleu 80% të kapitalit të Lancer sh.a përmes një shkëmbimi aksionesh prej 3 aksionesh në Commando sh.a për çdo 5 aksione të blera në Lancer sh.a. Vlera e drejtë e çdo aksioni Commando sh.a më 1 janar 2021 ishte €5. Vlera e drejtë e çdo aksioni të Lancer sh.a më 1 janar 2021 ishte €6. Commando sh.a ende nuk e ka kontabilizuar emetimin e aksioneve në pasqyrat e tij financiare dhe nuk e ka regjistruar ende investimin në Lancer sh.a.
- (ii) Vlera e drejtë e pasurive neto të identifikueshme të Lancer sh.a ishte e barabartë me vlerën kontabël të tyre më 1 janar 2021, përveç tokave dhe ndërtesave, vlera e drejtë e të cilave tejkalonte vlerën kontabël me €10 milionë. Nga kjo shumë, 50% i përket ndërtesave, jeta e mbetur e të cilave në 1 janar 2021 ishte 10 vite.
- (iii) Më 1 janar 2021, Commando sh.a bleu gjithashtu 2.5 milionë aksione të Spirit sh.a për një shumë prej €15 milionë.
- (iv) Fitimet e mbajtura të Lancer sh.a dhe Spirit sh.a më 1 janar 2021 ishin €15 milion dhe €4 milion respektivisht.
- (v) Gjatë vitit deri më 31 dhjetor 2021 Lancer sh.a furnizoi mallra Commando sh.a-në me vlerë prej € 8 milionë. Lancer sh.a shton një marzhë prej 25% mbi koston në çmimin e këtyre mallrave. Një e katërta e mallrave të blera nga Commando sh.a janë ende në stoqet e Commando sh.a me 31 dhjetor 2021.

- (vi) Zëri i mirë në blerjen e Lancer sh.a është dëmtuar për €2 milionë ndërsa investimi në Spirit sh.a është dëmtuar për €3 milionë.
- (vii) Të pagueshmet Commando sh.a-në përfshijnë €2 milion të pagueshme për Lancer sh.a. Megjithatë, të arkëtueshmet e Lancer sh.a përfshijnë €3 milion si të arkëtueshme nga Commando sh.a. Diferenca midis të pagueshmeve të Commando sh.a-së dhe të arkëtueshmeve të Lancer sh.a është për shkak të një pagese nga Commando sh.a që nuk është pranuar ende nga Lancer sh.a.
- (viii) Është politikë e grupit të vlerësoj interesin jo-kontrollues sipas vlerës së plotë (të drejtë). Për këtë qëllim, vlera e drejtë e çdo aksioni të Lancer sh.a më 1 janar 2021 është përfaqësuese e vlerës së drejtë të aksioneve të interesit jo-kontrollues.

**Kërkohe:**

- (a) **Përgatite pasqyrën e konsoliduar të Pozitës Financiare të grupit Commando sh.a për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2021.** (25 pikë)

## Pasqyra e konsoliduar e pozitës financiare të grupit Commando me 31 dhjetor 2021

|                                                              | €'000          |
|--------------------------------------------------------------|----------------|
| <i>Pasuritë jo-qarkulluese:</i>                              |                |
| PFP (L11)                                                    | 100,000        |
| Zëri i mirë (L12)                                            | 103,000        |
| Investimi në shoqëri (L13)                                   | 16,000         |
| Investimet tjera (L1)                                        | <u>55,000</u>  |
|                                                              | 274,000        |
| <i>Pasuritë qarkulluese:</i>                                 |                |
| Stoqet (10,000 + 15,000 - 400 FPR L15)                       | 24,600         |
| Të arkëtueshmet tregtare dhe të tjera (L16)                  | 37,000         |
| Paraja dhe ekuivalentët e parasë (1,000+2,000+1,000 tranzit) | <u>4,000</u>   |
|                                                              | <u>65,600</u>  |
| <b>Total pasuritë</b>                                        | <b>339,600</b> |
| <b>Ekuiteti dhe detyrimet</b>                                |                |
| <i>Ekuiteti:</i>                                             |                |
| Kapitali aksionar (50,000+50,000 x 80%/5 x3 x €1)            | 74,000         |
| Premia e aksioneve (50,000 x 80%/5 x 3 x €4 (€5-€1))         | 96,000         |
| Fitimet e mbajtura (L17)                                     | 56,680         |
| IJK (L18)                                                    | <u>61,420</u>  |
| Total ekuiteti                                               | 288,100        |
| <i>Detyrimet afatgjata</i>                                   |                |
| Kredia afatgjatë (20,000+2,000)                              | 22,000         |
| <i>Detyrimet afstshkurta</i>                                 |                |
| Të pagueshmet tregtare dhe të tjera (21,500 + 10,000 -2,000) | <u>29,500</u>  |
| <b>Total ekuiteti dhe detyrimet</b>                          | <b>339,600</b> |

### Llogaritjet:

| <b>L11. PFP</b>                       | <b>€'000</b> |
|---------------------------------------|--------------|
| <u>Shumat e dhëna</u>                 |              |
| Commando sh.a                         | 50,500       |
| Lancer sh.a                           | 40,000       |
| Korigjim                              |              |
| VD                                    | 10,000       |
| Zhvlerësimi shtesë 50%x 10,000/10 x 1 | <u>(500)</u> |
|                                       | 100,000      |

| <b>L12. Zëri i mirë</b>                        | <b>€'000</b>  | <b>€'000</b>    |
|------------------------------------------------|---------------|-----------------|
| <i>Kosto e blerjes:</i>                        |               |                 |
| Emetimi i aksioneve (50,000 x 80% /5 x 3 x €5) | 120,000       |                 |
| IJK VD (50,000 x 20% x €6)                     | <u>60,000</u> |                 |
| VD e PN ne blerje.                             |               |                 |
| AZ                                             | 50,000        |                 |
| FM                                             | 15,000        |                 |
| VD korigjim                                    | <u>10,000</u> |                 |
|                                                |               | <u>(75,000)</u> |

|                       |                |
|-----------------------|----------------|
| Zëri i mirë në blerje | 105,000        |
| Minus dëmtimi         | <u>(2,000)</u> |
|                       | <b>103,000</b> |

|                                           |                |
|-------------------------------------------|----------------|
| <b>L13. Investimi në shoqëri</b>          | <b>€'000</b>   |
| Kosto e investimiti.                      | 15,000         |
| Pjesa e FM pas blerjes 25% (20,000-4,000) | 4,000          |
| Minus dëmtimi                             | <u>(3,000)</u> |
|                                           | <b>16,000</b>  |

|                                 |                 |
|---------------------------------|-----------------|
| <b>L14. Investimet tjera</b>    | <b>€'000</b>    |
| <u>Shumat e dhëna</u>           |                 |
| Commando sh.a                   | 50,000          |
| Lancer sh.a                     | 20,000          |
| Minus investimet në Spirit sh.a | <u>(15,000)</u> |
|                                 | <b>55,000</b>   |

|                                 |                |
|---------------------------------|----------------|
| <b>L15 Fitimi i porealizuar</b> | <b>€'000</b>   |
| Shitjet                         | 8,000          |
| Kosto 8,000 /1.25)              | <u>(6,400)</u> |
| Fitimi                          | 1,600          |
| Fitimi i porealizuar ¼          | 400            |

|                                                   |                |
|---------------------------------------------------|----------------|
| <b>L16. Të arkëtueshmet tregtare dhe të tjera</b> | <b>€'000</b>   |
| <u>Shumat e dhëna</u>                             |                |
| Commando sh.a                                     | 30,000         |
| Lancer sh.a                                       | 10,000         |
| Ndërgrupore                                       | <u>(3,000)</u> |
|                                                   | <b>37,000</b>  |

|                                                   |                      |                    |                    |
|---------------------------------------------------|----------------------|--------------------|--------------------|
| <b>L17 Fitimet e mbajtura</b>                     | <b>Commando sh.a</b> | <b>Lancer sh.a</b> | <b>Spirit sh.a</b> |
|                                                   | <b>€'000</b>         | <b>€'000</b>       | <b>€'000</b>       |
| Sipas detyres                                     | 50,000               | 25,000             | 20,000             |
| Para blerjes                                      | -                    | <u>(15,000)</u>    | <u>(4,000)</u>     |
| Pas blerjes                                       |                      | 10,000             | 16,000             |
| Pjesa e fitimeve të shoqerisë 25% x 16,000        | 4,000                |                    |                    |
| Zhvlerësimi shtesë                                |                      | (500)              |                    |
| Fitimet e porealizuara                            |                      | (400)              |                    |
| Dëmtimi i zërit të mire                           |                      | <u>(2,000)</u>     |                    |
|                                                   |                      | 7,100              |                    |
| Dëmtimi i investimit në shoqëri                   | (3,000)              |                    |                    |
| Pjesa e fitimeve që i takon prindit (80% x 7,100) | <u>5,680</u>         |                    |                    |
| Fitimet e mbajtura të prindit                     | <b>56,680</b>        |                    |                    |

|                                          |               |
|------------------------------------------|---------------|
| <b>L18. IJK</b>                          | <b>€'000</b>  |
| Në blerje                                | <u>60,000</u> |
| Pjesa e fitimeve pas blerje: 7,100 x 20% | <u>1,420</u>  |
|                                          | <b>61,420</b> |

2.

(a) SNK 41 *Agrikultura*, jep udhëzime për kontabilitetin e aktivitetit agrikorikultor. Pasuritë biologjike, prodhimet bujqësore në momentin e vjeljes dhe grantet qeveritare në lidhje me pasuritë biologjike janë brenda fushëveprimit të SNK 41.

**Kërkohet:**

**Tregoni kërkesat e SNK 41 *Agrikultura*, në lidhje me njohjen dhe matjen e pasurive biologjike dhe prodhimeve agrikorikultore në përgatitjen dhe paraqitjen e pasqyrave financiare.** (5 pikë)

(b) SNRF 13 *Matja e vlerës së drejtë* jep udhëzime për matjen e vlerës së drejtë kur një SNRF specifike kërkon ose lejon vlerën e drejtë si bazë matjeje. Ai siguron një kornizë të vetme SNRF për matjen e vlerës së drejtë dhe kërkon dhënie informacionesh shpjeguese për matjen e vlerës së drejtë.

**Kërkohet:**

**Përshkruani kërkesat e përgjithshme të SNRF 13 në lidhje me përcaktimin e vlerës së drejtë dhe hierarkisë së vlerës së drejtë.** (5 pikë)

(c) Një instrument financiar është çdo kontratë që i jep një pasuri financiare njëerës palë (një entiteti) dhe një detyrim financiar ose instrument ekuiteti entitetit tjetër.

**Kërkohet:**

**Shpjegoni njohjen fillestare, matjet dhe klasifikimet që SNRF 9 *Instrumentet financiare* identifikon për pasuritë financiare dhe bazën e matjes që është e përshtatshme për çdo klasifikim. Në përgjigjen tuaj, tregoni qartë çdo përjashtim nga klasifikimet normale që mund të zbatohen në rrethana specifike** (5 pikë)

(d) Objektivi i SNK 10 *Ngjarjet pas periudhës raportuese* është të përshkruajë: kur një entitet duhet të korigjoj pasqyrat e tij financiare për ngjarjet pas periudhës raportuese; dhe dhënien e informacioneve shpjeguese që një entitet duhet të japë për datën kur pasqyrat financiare janë autorizuar për publikim dhe rreth ngjarjeve pas periudhës së raportimit.

**Kërkohet:**

(i) Tregoni dallimin midis ngjarjeve korigjuese dhe jo-korigjuese. (2 pikë)

(ii) Tregoni trajtimin kontabël të një ngjarjeje korigjuese dhe një ngjarjeje jo-korigjuese (2 pikë)

(iii) Jepi dy (2) shembuj të një ngjarjeje korigjuese. (1 pikë)

[Total: 20 pikë]

## **(a) SNK 41 Agrikultura**

### **Njohja**

Kriteret e njohjes janë shumë ngjashme me ato të pasurive tjera, në atë se kafshët ose bimët duhet

të njihen si pasuri në rrethanat e mëposhtme.

(a) Entiteti kontrollon pasurinë si rezultat i ngjarjeve të kaluara.

(b) Është e mundur që përfitimet e ardhshme ekonomike të shoqëruara me pasurinë do të rrjedhin drejt entitetit.

(c) Vlera e drejtë ose kosto e pasurisë për entitetin mund të matet me besueshmëri.

### **Matja**

#### **Pasuritë biologjike**

Pasuritë biologjike brenda fushëveprimit të SNK 41 maten në njohjen fillestare dhe në datat e mëvonshme të raportimit me vlerën e drejtë minus kostot e vlerësuara për shitje, përveç nëse vlera e drejtë nuk mundet të matet në mënyrë të besueshme.

Nëse nuk ka matje të besueshme të vlerës së drejtë (pa çmim të kuotuar tregu në një treg aktiv dhe matjet alternative të vlerës së drejtë të pabesueshme), pasuritë biologjike paraqiten me kosto minus amortizimi i akumuluar dhe humbjet e akumuluar nga dëmtimi. Nëse rrethanat ndryshojnë dhe vlera e drejtë bëhet e matshme me besueshmëri, një kalim në vlerën e drejtë kërkohet më pak kosto.

#### **Prodhimi agrikoror**

Prodhimi agrikoror duhet të matet në fund të çdo viti sipas vlerës së drejtë minus kostot e vlerësuara në momentin e shitjes, deri në atë masë që është burim nga një pasuri biologjike e entitetit, të cilat gjithashtu vlerësohen sipas vlerës së drejtë. Kjo është logjike kur ju e keni parasysh që, deri në vjela/korrje, prodhimi agrikoror ishte vlerësuar sipas vlerës së drejtë gjithsesi si pjesë e pasurisë biologjike.

Ndryshimi në shumën bartëse të prodhimit agrikoror të mbajtur në fund të vitit duhet të njihet si e ardhur ose shpenzim në fitim ose humbje. Kjo do të jetë shumë e rrallë pasi që prodhimi zakonisht shitet brenda një kohe të shkurtër, ashtu që prodhimi i cili mbahet brenda dy periudhave raportuese mbahet për ndonjë qëllim specifik të menaxhmentit dhe pasojat e kësaj duhet të reflektohen në periudhën aktuale.

Prodhimi agrikoror që është vjelur/korruar për aktivitetet e procesimit ose tregtimit brenda operacioneve të integruara agrikulturore/agrobiznesore duhet të matet sipas vlerës së drejtë në datën e vjelave/korrjeve dhe kjo shumë konsiderohet si kosto për aplikimin e SNK 2 tek stoqet që rrjedhin me pas.

#### **Trajtimi i fitimit ose humbjes**

- Fitimi nga njohja fillestare e pasurive biologjike me vlerën e drejtë minus kostot e shitjes, dhe ndryshimet në vlerën e drejtë minus kostot për shitjen e pasurive biologjike gjatë një periudhe, përfshihen në fitim ose humbje.

- Një fitim nga njohja fillestare (p.sh. si rezultat i korrjes) të prodhimit agrikoror me vlerën e drejtë minus kostot e shitjes përfshihen në fitim ose humbje për periudhën në të cilën krijohet.

## **(b) SNRF 13 Matjet e vlerës së drejtë**

SNRF 13 e përkufizon vlerën e drejtë si çmimi që do të pranohej për të shitur një pasuri ose që do paguhej për të transferuar një detyrim, në një transaksion të zakonshëm midis pjesëmarrësve të tregut, në datën e matjes.

Objektivi i matjes së vlerës së drejtë është të vlerësojë çmimin me të cilin një transaksion i zakonshëm për shitjen e pasurisë ose transferimin e detyrimit do të ndodhte ndërmjet tregut Pjesëmarrësve në treg në datën e matjes në kushtet aktuale të tregut.

Ky standard kërkon që të mirren parasysh si në vijim gjatë përcaktimit të vlerës së drejtë.

- (a) Pasurinë dhe detyrimin që është duke u matur.
- (b) Tregun kryesor (atë në të cilin pjesa më e madhe e aktivitetit ndodh) ose kur nuk ka treg kryesor, tregun më të favorshëm (atë në të cilin çmimi më i mirë mund të arrihet) në të cilin një transaksion i zakonshëm do të kryhej për pasurinë ose detyrimin.
- (c) Shkalla më e lartë dhe më e mirë e përdorimit të pasurisë ose detyrimit dhe nëse përdoret si i vetëm apo së bashku me pasuritë ose detyrimet tjera.
- (d) Supozimet që pjesëmarrësit në treg do të përdornin gjatë vendosjes së çmimit të pasurisë ose detyrimit

Pasi të jenë marrë parasysh këta faktorë, SNRF 13 jep një hierarki të inputeve për arritjen tek vlera e drejtë. Kërkon që inputet e nivelit 1 të përdoren kur është e mundshme:

|          |                                                                                                                                                 |
|----------|-------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| Niveli 1 | Çmimet e kuotuar (të parregulluara) në tregjet aktive, për pasuri ose detyrime të njëjtë, që entiteti ka mundësi t'i përdorë në datën e matjes. |
| Niveli 2 | Inpute të tjera përveç se çmimet e kuotuar që janë të evidentueshëm për pasurinë                                                                |
| Niveli 3 | Inpute të paverifikueshme për pasurinë ose detyrimin .                                                                                          |

## **(c) SNRF 9 Instrumentet Financiare**

SNRF 9 aplikohet në të gjitha entitetet dhe në të gjitha llojet e instrumenteve financiare përveç atyre që përjashtohen në mënyrë specifike, për shembull investimet në filiala, partneritete dhe ndërmjarrje.

Pasuria financiare ose detyrimi financiar duhet të njihet në pasqyrën e pozitës financiare kur entiteti raportues bëhet palë në kushtet kontraktore të instrumentit

Në njohje, SNRF 9 kërkon që pasuritë financiare të klasifikohen si të matura në njëren nga këto:

- Kosto e amortizuar
- Vlerën e drejtë nëpërmjet të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse; ose
- vlerën e drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes

Sipas SNRF 9 të gjitha pasuritë financiare duhet fillimisht të maten sipas koston = vlerën e drejtë plus koston e transaksionit. Detyrimet financiare duhet të maten sipas çmimit të transaksionit, pra vlerës së drejtë të konsideratës së pranuar.

Pas njohjes fillestare, SNRF 9 kërkon që një entitet të matë pasuritë financiare ose sipas kostos së amortizuar, vlerës së drejtë nëpërmjet të ardhurave tjera gjithëpërfshirëse ose vlerës së drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes duke u bazuar në:

- (a) Modelin e biznesit të entitetit për menaxhimin e pasurive financiare
- (b) karakteristikat e rrjedhave kontraktuale të parasë të pasurisë financiare

Një pasuri financiare matet sipas kostos së amortizuar nëse të dy kushtet e mëposhtme përmbushen:

- (a) Pasuri mbahen brenda një modeli të biznesit objektiv i të cilit është të mbajë pasurinë me qëllim të arkëtimit të rrjedhave kontraktuale të parasë.
- (b) kushtet kontraktuale të pasurisë financiare shkaktojnë në datat e specifikuara rrjedha monetare të cilat janë vetëm pagesa të kryegjësë dhe të interesit për shumën e papaguar të kryegjësë.

Pas njohjes fillestare, të gjitha pasuritë financiare përveç atyre të mbajtura sipas vlerës së drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes duhet të rimaten ose sipas vlerës së drejtë ose kostos së amortizuar.

#### **(d) i SNK 10 Ngjarjet pas periudhës raportuese**

(i)

Ngjarjet që kanë ndodhur pas periudhës raportuese janë ato ngjarje, të favorshme ose të pafavorshme, që ndodhin midis përfundimit të periudhës raportuese dhe datës kur pasqyrat financiare autorizohen për publikim. Mund të identifikohen dy lloje të ngjarjeve:

- Ato të cilat japin dëshmi për kushtet që kanë ekzistuar në fund të periudhës raportuese – korrigjuese
- Ato të cilat janë tregues të kushteve që janë paraqitur pas periudhës raportuese – jokorrigjuese

(ii)

Një entitet duhet t'i korrigjoj shumat e njohura në pasqyrat financiare për të reflektuar ngjarjet korrigjuese pas periudhës raportuese. Një entitet nuk duhet t'i korrigjoj shumat e njohura në pasqyrat financiare për të reflektuar ngjarjet jo-korrigjuese pas periudhës raportuese. Disa ngjarje jo-korrigjuese pas periudhës raportuese kërkohet të shpalosen.

(iii) Shembuj të ngjarjeve korrigjuese do të ishin:

- Dëshmi e një zvogëlimi permanent të vlerës së pronës para përfundimit të vitit
- Shitja e stoqeve pas periudhës raportuese për më pak se vlera bartëse në fund të vitit
- Jo-solventiteti i një klienti me një saldo borxhi në fund të vitit
- Shumat e pranuar apo paguara lidhur me kërkesat ligjore ose për sigurim të cilat ishin në negociatë në fund të vitit
- Përcaktimi para përfundimit të vitit i çmimit blerës apo shitës i pasurive të shitura apo të blera para përfundimit të vitit
- Dëshmi e një zvogëlimi permanent të vlerës së një investimit para përfundimit të vitit
- Zbulimi gabimit apo mashtrimit që tregon se pasqyrat financiare kanë qenë të pasakta

### 3.

#### a)

F-35 sh.a është një kompani publike e listuar në bursë. Ajo është duke shqyrtuar trajtimin në kontabilitet të pasurive të paprekshme. Me poshtë janë çështje të cilat kompania është duke i shqyrtuar për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2021.

- i) Më 1 korrik 2021 F-35 sh.a bleu F-16 sh.a, një kompani e vogël që është e specializuar në hulumtimin dhe zhvillimin e barnave farmaceutike. Vlera e blerjes ishte me anë të shkëmbimit të aksioneve dhe vlerësohej në €35 milionë. Vlera e drejtë e pasurive neto të identifikueshme të F-16 sh.a ishte €15 milionë (duke përjashtuar patenten e përmendur më poshtë). F-16 sh.a zotëron një patentë për një ilaç të suksesshëm të krijuar vetë që ka një jetë të mbetur prej tetë vjetësh. Një kompani specialiste e vlerësimit, ka vlerësuar vlerën aktuale të kësaj patente në €10 milionë, megjithatë kompania është në pritje të rezultatit të provave klinike ku ilaçi është testuar për të trajtuar një sëmundje tjetër. Nëse provat janë të suksesshme, atëherë vlera e patentës vlerësohet të jetë €20 milionë. Kjo patentë nuk është e përfshirë në pasqyrat financiare të F-16 sh.a-së. Në pasqyrën e pozitës financiare të F-16 sh.a përfshihen €5 milionë për hulumtime mjekësore që janë kryer në emër të një klienti. **(4 pikë)**
- ii) F-35 sh.a përdor modelin e rivlerësimit në kontabilitetin e pronës, fabrikës dhe paisjeve. Më 1 korrik 2021 F-35 sh.a për here të parë rivlerësoi tokën dhe ndërtesën me vlerë bartese prej €30 milionë dhe €50 milionë respektivisht, në €80 milionë dhe €100 milionë respektivisht. Në atë datë jeta e mbetur e parashikuar e ndërtesës ishte 25 vjet. **(3 pikë)**
- iii) F-35 sh.a kishte €20 milionë shpenzime zhvillimi të kapitalizuara me kosto të paraqitura më 1 janar 2021 në lidhje me produktet aktualisht në prodhim. Një projekt i ri filloi në të njëjtën datë. Faza e hulumtimi të projektit të ri zgjati deri më 30 shtator 2021 dhe shkaktoi €1.4 milion kosto. Që nga ajo datë projekti shkaktoi kosto zhvillimi prej €800,000 në muaj. Më 1 dhjetor 2021, drejtorët u bënë të sigurt se projekti do të ishte i suksesshëm dhe do të jepte një fitim shumë më të madh se kostot. Projekti ishte ende në zhvillim me 31 dhjetor 2021. Shpenzimet e zhvillimit të kapitalizuara amortizohen me 20% në vit duke përdorur metodën lineare. **(3 pikë)**
- iv) Në periudhën aktuale kontabël, F-35 sh.a ka shpenzuar €3 milionë për dërgimin e stafit të tij në kurse trajnimi të specializuara. Ndonëse këto kurse kanë qenë të shtrenjta, ato kanë çuar në një përmirësim të dukshëm në cilësinë e prodhimit dhe stafi tani ka nevojë për më pak mbikëqyrje. Kjo nga ana tjetër ka çuar në një rritje të të ardhurave dhe ulje të kostove. Drejtorët e F-35 sh.a besojnë se këto përfitime do të vazhdojnë për të paktën tre vjet dhe dëshirojnë t'i trajtojnë kostot e trajnimit si një pasuri. **(2 pikë)**

#### Kërkohej:

Tregoni trajtimin në kontabilitet për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2021 për secilin zë më sipër nga i) deri në iv). **Total (12 pikë)**

**b)**

Një njësi gjeneruese e parasë përfshinë pasuritë e mëposhtme:

|                     | <b>€'000</b> |
|---------------------|--------------|
| Ndërteat            | 700          |
| Fabrika dhe paisjet | 200          |
| Zëri i mirë         | 90           |
| Paraja e gatshme    | <u>20</u>    |
|                     | <b>1,010</b> |

Njëra nga makineritë, me vlerë €40,000, është e dëmtuar dhe do të duhet të fshihet. Shuma e rikuperueshme e njësisë gjeneruese të parasë është vlerësuar në €750,000.

**Kërkohet:**

Tregoni vlerën bartëse të njësisë gjeneruese të parasë dhe të pasurive të saj pas njohjes së humbjes nga dëmtimi. (8 pikë)

## 3.

## a)

€m

## i)

**Zeri i mire**

|                                          |           |
|------------------------------------------|-----------|
| Konsiderata                              | 35        |
| VD e PN                                  | (15)      |
| VD e patentes                            | (10)      |
| Zeri i mire në blerje                    | 10        |
| Dentimi i zerit të mirë                  | <u>-</u>  |
| <b>Zëri i mirë në datën e raportimit</b> | <b>10</b> |

**Patenta**

|                                      |                |
|--------------------------------------|----------------|
| Vlera e drejte në blerjen e F-16     | 10             |
| Zhvleresimi (10/8/12x6)              | <u>(0.625)</u> |
| <b>VB në pasqyrat e konsoliduara</b> | <b>9.375</b>   |

## ii)

Toka

Ndërtesa

Total

€m

€m

€m

|                                         |           |                          |            |
|-----------------------------------------|-----------|--------------------------|------------|
| Vlera bartëse                           | 30        | 50                       | 80         |
| Perfitimi nga rivleresimi               | <u>50</u> | <u>50</u>                | <u>100</u> |
| Rivleresimi 1 korrik 2021               | 80        | 100                      | 180        |
| Zhvleresimi pas rivleresimit            | <u>-</u>  | <u>(2)</u> (100/25/12x6) | <u>(2)</u> |
| <b>Vlera bartese me 31 dhjetor 2021</b> | <b>80</b> | <b>98</b>                | <b>178</b> |

## iii)

**Për vitin e perfunduar me 31 dhejtor 2021**

€m

**PFH**

|                                         |     |
|-----------------------------------------|-----|
| Kosto e hulumtimit                      | 1.4 |
| Shpenzimet e amortizimit (20m x 20%)    | 4.0 |
| Shpenzimet e zhvillimit (2 muaj x €0.8) | 1.6 |

Shënim: Kostot e kapitalizura të zhvillimit për muajin dhjetor 2021 nuk amortizohen pasi që projekti është ende në zhvillim

**Me 31 dhjetor 2021**

€m

**PPF**

|                                   |      |
|-----------------------------------|------|
| Kosto e zhvillimit (20 - 4 + 0.8) | 16.8 |
|-----------------------------------|------|

## iv)

Kostot e trajnimit duhet të shpenzohen dhe nuk njihen si pasuri

| b)                  | Para dëmtimit | Dëmtimi      | Pas dëmtimit |
|---------------------|---------------|--------------|--------------|
|                     | €'000         | €'000        | €'000        |
| Ndërteat            | 700           | (106)        | 594          |
| Fabrika dhe paisjet | 200           | (64)*        | 136          |
| Zëri i mirë         | 90            | (90)         | -            |
| Paraja e gatshme    | <u>20</u>     | <u>-</u>     | <u>20</u>    |
|                     | <b>1,010</b>  | <b>(260)</b> | <b>750</b>   |

| <i>Llogaritjet:</i>                      | Ndertesat | Fabrika | Total |
|------------------------------------------|-----------|---------|-------|
|                                          | 700       | 160**   | 860   |
| Proporcioni (rrumbullakësuar)            | 81.4%     | 18.6%   | 100%  |
| Dëmtimi që shperndahet (260-90-40 = 130) | (106)     | (24)    | (130) |

\* 40 + 24

\*\* pas zbritjes së dëmtimit prej €40 mijë.

#### 4.

a) B2 sh.a ka fituar një kontratë në vlerë prej €10 milion për të ndertuar një aeroport ushtarak. Kontrata është nënshkruar me 4 korrik 2020 dhe puna pritët të zgjasë dy vite. Kjo është një kontratë ku detyrimet për performancë përmbushen përgjatë kohës dhe progresi në përmbushjen e detyrimeve të performancës duhet të matet sipas % të punës së përfunduar siç është çertifikuar nga një inspektor i punimeve. B2 sh.a ka një të drejtë të detyrueshme për pagesë për performancën e përfunduar deri më datë.

Me 31 dhjetor 2021 dhe 2020 detajet e kontratës ishin si në vijim:

|                                     | 2021       | 2020       |
|-------------------------------------|------------|------------|
|                                     | €          | €          |
| Total vlera e kontratës             | 10,000,000 | 10,000,000 |
| Kosto deri me datë                  | 4,000,000  | 2,000,000  |
| Kosto e vlerësuar deri në përfundim | 1,000,000  | 2,000,000  |
| Puna e faturuar deri me datë        | 3,500,000  | 1,000,000  |
| Paraja e pranuar deri me datë       | 3,000,000  | 500,000    |
| % çertifikuar e punës së përfunduar | 80%        | 40%        |

#### Kërkohet:

**Në pajtim me SNRF 15 Të hyrat nga Kontratat me klientë tregoni ekstraktet e pasqyres së fitimit ose humbjes dhe pasqyrës së pozitës financiare të B2 sh.a për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2020 dhe 31 dhjetor 2021.**

**(10 pikë)**

b) Më 1 janar 2021, Apache sh.a mori hua €6 milionë për një periudhë njëvjeçare, ekskluzivisht për të financuar ndërtimin e fabrikës së prodhimit.

Norma e interesit të kredisë është 6% dhe është e pagueshme në afatin e maturimit të kredisë.

Ndërtimi ka filluar më 1 shkurt 2021 por asnjë aktivitet i ndërtim nuk është bërë nga data 1 shkurt 2021 deri më 31 mars 2021 për shkak të grevave nga punonjësit.

Fabrika e prodhimit u ndërtua dhe ishte e disponueshme për përdorim më 31 dhjetor 2021 me një kosto të ndërtimit prej €6 milionë.

#### Kërkohet:

**Llogaritë vlerën bartëse të fabrikës së prodhimit në pasqyrën e pozitës financiare të Apache sh.a-së me 31 dhjetor 2021.**

**(5 pikë)**

c)

Me 1 janar 2021 Stratofortress sh.a mori një makinë me lizing për 5 vite. Vlera e tanishme e pagesave të lizingut me 1 janar 2021 ishte €3,100,000. Pagesat e lizingut prej €700,000 në vit janë të pagueshme në fillim të vitit dhe pagesa e parë fillon me 2 janar 2021. Norma e interesit e nënkuptuar në lizing është 6.3%.

#### Kërkohet:

**Tregoni ekstraktet e pasqyres së fitimit ose humbjes dhe pasqyrës së pozitës financiare të Stratofortress sha për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2021.**

**(5 pikë)**

4

a)

**Pasqyra e fitimit ose humbjes**

|               | 2021               | 2020               |
|---------------|--------------------|--------------------|
|               | €                  | €                  |
| Të hyrat      | 4,000,000          | 4,000,000          |
| Shpenzimet    | <u>(2,400,000)</u> | <u>(1,600,000)</u> |
| <b>Fitimi</b> | <b>1,600,000</b>   | <b>2,400,000</b>   |

**Pasqyra e pozitës financiare**

|                               | 2021               | 2020               |
|-------------------------------|--------------------|--------------------|
|                               | €                  | €                  |
| Kosto deri me datë            | 4,000,000          | 1,600,000          |
| Fitimi deri me datë           | <u>4,000,000</u>   | <u>2,400,000</u>   |
|                               | 8,000,000          | 4,000,000          |
| Minus shumat e faturuara      | <u>(3,500,000)</u> | <u>(1,000,000)</u> |
| <b>Pasuri e kontratës</b>     | <b>4,500,000</b>   | <b>3,000,000</b>   |
| <br>                          |                    |                    |
| <b>Llogaria e arkëtueshme</b> | <b>500,000</b>     | <b>500,000</b>     |
| <b>Paraja</b>                 | <b>3,000,000</b>   | <b>500,000</b>     |

**Llogaritjet**

**2021**

Te hyrat  $80\% \times 10,000,000 = 8,000,000 - 4,000,000 = 4,000,000$

Shpenzimet  $80\% \times (4,000,000 + 1,000,000) = 4,000,000 - 1,600,000 = 2,400,000$

Fitimi deri me date = (2020) 2,400,000 + (2021) 1,600,000 = 4,000,000

**2020**

Te hyrat  $40\% \times 10,000,000 = 4,000,000$

Shpenzimet  $40\% \times (2,000,000 + 2,000,000) = 1,600,000$

b)

|                                                                    | €                |
|--------------------------------------------------------------------|------------------|
| Kosto e ndërtimit                                                  | 6,000,000        |
| Kapitalizimi i kostove të huamarrjes:<br>€6m x 6% x 9/12 =         | <u>270,000</u>   |
| Total kosto e kapitalizuar dhe vlera bartëse me at 31 dhejtor 2021 | <b>6,270,000</b> |

c)

| <b>Pasqyra e fitimit ose humbjes (ekstrakt) 31 dhjetor 2021</b>              | €         |
|------------------------------------------------------------------------------|-----------|
| Shpenzimet e interesit ((3,100,000 - 700,000) x 6.3%)                        | (151,200) |
| Shpenzimet e zhvleresimit (3,100,000 / 5 vite)                               | (620,000) |
| <b>Pasqyra e pozites financiare (ekstrakt) 31 dhjetor 2021</b>               | €         |
| Pasuria me të drejtë të përdorimit (3,100,000 - 620,000)                     | 2,480,000 |
| Detyrimet afat gjata ndaj lizingut (3,100,000 - 700,000 + 151,200 - 700,000) | 1,851,200 |
| Detyrimet afatshkurtra ndaj lizingut                                         | 700,000   |

5. Informatat në vijim kanë të bëjnë me pasqyrën e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave tjera gjithëpërfshirëse të Chinook sh.a për vitin e përfunduar 31 dhjetor 2021.

|                                  | <b>€ milion</b> |
|----------------------------------|-----------------|
| Shitjet                          | 550             |
| Kosto e shitjeve                 | <u>(340)</u>    |
| Fitimi bruto                     | 210             |
| Shpenzimet operative             | (90)            |
| Kosto financiare                 | <u>(30)</u>     |
| Fitimi para tatimit              | 90              |
| Tatimi                           | <u>(27)</u>     |
| Fitimi për vitin                 | 63              |
|                                  |                 |
| Saldo tjera me 31 dhjetor 2021   | <b>€ milion</b> |
| Kapitali aksionar (€0.20 secila) | 100             |
| Fitimet e mbajtura               | 50              |
| Rezervat e rivlerësimit          | <u>200</u>      |
| Total ekuiteti                   | 350             |
| Detyrimet afatgjata              | 150             |

Shënim:

- Divedidenda e paguar per vitin 2021 ishte €50 milion
- Cmimi për aksion €5.0

**Kërkohet:**

**Llogaritni si në vijim:**

- **Fitimin bazik për aksion** (2 pikë)
- **Dividenden për aksion** (2 pikë)
- **Rentabilitetin e dividendes** (2 pikë)
- **Koeficientin C/F** (2 pikë)
- **Marzhen e fitimit bruto dhe marzhen e fitimit neto** (2 pikë)
- **Kthimin në kapitalin e angazhuar** (2 pikë)
- **Qarkullimin e pasurisë** (1 pikë)
- **Kthimin në ekuitet (KNE)** (1 pikë)
- **Mbulimin e interesit** (1 pikë)

**(Total 15 pikë)**

5.

**Fitimin bazik për aksion**

Fitimi për vitin/ Numri mesatar i ponderuar i aksioneve

$$63/500 = \text{€}0.126$$

**Dividenda për aksion**

Dividenda për vitin/ Numri mesatar i ponderuar i aksioneve

$$50/500 = \text{€}0.10$$

**Rentabilitetin e dividendes**

Dividenda për aksion/ Cmimi për aksion

$$\text{€}0.1/\text{€}5.0 = 2.0\%$$

**Koeficienti C/E**

Cmimi për aksion/ Fitimin bazik për aksion

$$5.0/0.126 = 39.68 \text{ here}$$

**Marzhen e fitimit bruto dhe marzha e fitimit neto**

Fitimi bruto/shitjet;

$$210/550 = 38.18\%;$$

Fitimi neto/shitjet

$$63/550 = 11.45\%$$

**Kthimin në kapitalin e angazhuar**

Fitimi para interesit dhe tatimit / (kapitali i angazhuar)

$$120/500 = 24.0\%$$

**Qarkullimi i pasurisë.**

Shitjet / (kapitali i angazhuar)

$$550/500 = 1.1 \text{ here}$$

**Kthimi në ekuitet (KNE)**

$$63/350 = 18.00\%$$

**Mbulimi i interesit**

FPIT/ pagesat e interesit

$$120/30 = 4.00 \text{ here}$$